IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Gusht 2026

Restaurim, muret antike pranë shkollës 9-vjeçare "Eftali Koçi", Durrës

Restaurim, Xhamia e Muradies

Ndërhyrje Restauruese, Manastiri i Kryeengjëjve, Derviçan

Inspektim, Kalaja e Peqinit

Aktivitet praktik në terren, Universiteti Polis

Restaurim, Kisha e Shën Gjergjit, Suk, Roskovec

Botimi nr. 08

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim, muret antike pranë shkollës 9-vjeçare “Eftali Koçi”, Durrës

Vijojnë punimet për restaurimin e mureve antike të zbuluara pranë shkollës 9-vjeçare “Eftali Koçi” në Durrës dhe rehabilitimin e zonës përreth. Zbulimet arkeologjike kanë nxjerrë në dritë pjesë të sistemit fortifikues të qytetit antik, puse dhe mbetje të një akuadukti romak.

Një investim i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ruajtjen dhe valorizimin e trashëgimisë arkeologjike, duke e bërë atë të aksesueshme për qytetarët dhe vizitorët.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.








IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim, Xhamia e Muradies

Kanë nisur përgatitjet e kantierit, nën mbikëqyrjen e DRTK Vlorë, për restaurimin e Xhamisë së Muradies, një prej monumenteve më të rëndësishme të arkitekturës osmane në Shqipëri.

Projekti, i hartuar nga IKTK në bashkëpunim me TİKA, synon ruajtjen dhe restaurimin e këtij monumenti me vlera të veçanta historike, arkitekturore dhe kulturore. Punimet do të nisin së shpejti sipas standardeve bashkëkohore të konservimit, duke respektuar autenticitetin e monumentit.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Ndërhyrje Restauruese, Manastiri i Kryeengjëjve, Derviçan

Manastiri i Kryeengjëjve në Derviçan, një nga qendrat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të Dropullit, hyn në fazë restaurimi përmes ndërhyrjeve të planifikuara që përfshijnë edhe konakët lindorë e perëndimorë të kompleksit. Kjo nismë vjen në një moment të rëndësishëm për monumentin, pasi Kisha e Manastirit të Kryeengjëjve është shpallur së fundmi Pasuri Kulturore me statusin "Monument Kulture", Kategoria I, së bashku me zonën e saj mbrojtëse, duke njohur dhe forcuar vlerat e saj të jashtëzakonshme historike, arkitekturore dhe shpirtërore.

Pas dekadash degradimi dhe mungese mirëmbajtjeje, projekti synon të shpëtojë dhe rikthejë në funksion strukturat historike të konakëve, duke ruajtur origjinalitetin e tyre dhe karakterin tradicional të kompleksit. Ndërhyrjet, në 2 faza, do të përfshijnë restaurimin dhe konsolidimin e muraturave prej guri, rindërtimin e çative tradicionale me rrasa guri, restaurimin e elementeve prej druri, dyerve, dritareve dhe shkallëve, si dhe rikthimin e hapësirave funksionale bazuar në dokumentacionin historik dhe gjurmët ekzistuese në terren.

Ky projekt nuk synon vetëm restaurimin e një objekti, por edhe rijetëzimin e një kompleksi me rëndësi të veçantë për historinë, kulturën dhe besimin fetar në jug të Shqipërisë. Përmes ruajtjes së vlerave dhe rikthimit të funksioneve të tij historike, Manastiri i Kryeengjëjve do të vijojë të shërbejë si një pikë referimi për komunitetin lokal, vizitorët dhe turizmin kulturor në zonën e Bashkisë së Dropullit.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim, Kalaja e Peqinit

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, specialistët e IKTK-së zhvilluan një inspektim në Kalanë e Peqinit, si dhe një takim pune me përfaqësues të Bashkisë Peqin.

Gjatë takimit u diskutuan ndërhyrjet e nevojshme për restaurimin, konservimin dhe rijetëzimin e Kalasë, si dhe për funksionalizimin e Kullës A si hapësirë muzeale dhe ekspozuese, nën administrimin e Bashkisë Peqin. IKTK dhe Bashkia Peqin do të vijojnë bashkëpunimin për rikthimin e Kalasë në funksion të komunitetit, vizitorëve dhe jetës kulturore e turistike të qytetit.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Aktivitet praktik në terren, Universiteti Polis

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Polis, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë (DRTK Tiranë), u zhvillua një aktivitet praktik në terren , i fokusuar në rilevimin arkitektonik të objekteve të trashëgimisë kulturore. Ky angazhim shërben si një hap i rëndësishëm paraprak për zhvillimin e mëtejshëm të projekteve të përbashkëta, duke synuar avancimin e tyre deri në fazat konkrete të zbatimit.

Të organizuar në grupe, studentët u angazhuan në rilevimin e një sërë objektesh të rëndësishme të trashëhimisë kulturore me vlera kombëtare si: Banesa Toptani-Libohova, Sarajet e Toptanasve, Kalaja e Tiranës, Kalaja e Petrelës, Teqeja e Sheh Dyrrit dhe Banesa e Shijakasve.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim, Kisha e Shën Gjergjit, Suk, Roskovec

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në kuadër të mbikëqyrjes së punimeve, zhvilloi inspektimin në terren për nisjen e zbatimit të projektit "Restaurimi i Kishës së Shën Gjergjit", në fshatin Suk, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec.
Kisha e Shën Gjergjit është Monument Kulture i Kategorisë I, e ndërtuar në shek. XVIII, dhe paraqet dëmtime të konsiderueshme në strukturë, muratura, mbulesë dhe elemente të tjera arkitektonike. Projekti i restaurimit, i miratuar me Vendimin e KKTKM nr. 103, datë 27.03.2026, parashikon ndërhyrje restauruese dhe konsoliduese, me synim ruajtjen e vlerave historike, arkitektonike dhe autentike të monumentit. Ndërhyrjet do të realizohen duke respektuar parimet e ndërhyrjes restauruese dhe ruajtjes së autenticitetit të monumentit.

Gjatë inspektimit u verifikua gjendja aktuale e objektit dhe u dhanë orientimet përkatëse për organizimin dhe fillimin e punimeve, në përputhje me projektin e miratuar dhe kërkesat teknike të restaurimit. IKTK do të vijojë mbikëqyrjen e punimeve gjatë gjithë procesit të zbatimit, me qëllim garantimin e ruajtjes dhe transmetimit të vlerave të kësaj pasurie kulturore.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.